



**GJETJET PARAPRAKE DHE STUDIMI MBI KONSUMIN E ENERGJISË
ELEKTRIKE NË SHQIPËRI DHE SJELLJA KONSMATORE**

Tabela e përmbajtjes

| | | |
|------|--|----|
| 1. | Hyrje | 4 |
| 1.1 | Qëllimi i Studimit..... | 4 |
| 1.2 | Metodologjia e mbledhjes së të dhënave..... | 5 |
| 2. | Vështrim i përgjithshëm..... | 5 |
| 2.1. | Masat e kursimit të energjisë elektrike në vendet Evropiane..... | 6 |
| 2.2. | Mënyrat për të reduktuar konsumin e energjisë në jetën tonë përditshme, përfshijnë:. | 7 |
| 3. | Situata në Shqipëri e përdorimit të energjisë nga konsumatorë familjarë | 7 |
| 3.1 | Shërbimet kryesore familjare që përdorin energjinë elektrike | 7 |
| 3.2 | Fushat e përdorimit të energjisë elektrike në familje në vendin tonë si dhe disa tregues specifikë që përcaktojnë dhe një farë individualiteti të natyrës së këtij përdorimi. | 8 |
| 3.3 | Faktorët që ndikojnë në sasinë e energjisë elektrike që përdor një familje..... | 10 |
| 3.4 | Llogaritja e konsumit të energjisë për konsumatorë familjarë | 11 |
| 4. | Konsumi i energjisë në shtete të ndryshme..... | 13 |
| 4.1 | Konsumi mesatar vjetor në konsumatorët familjar në Itali: | 13 |
| 4.2 | Konsumi i energjisë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës - ShBA..... | 14 |
| 4.3 | Konsumi i energjisë për ndriçim në Evropë..... | 17 |
| 4.4 | Prodhimi i energjisë elektrike për vitin 2021 në Shqipëri..... | 18 |
| 4.5 | Veprimtaria e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike | 19 |
| 4.6 | Struktura e Konsumit të Energjisë Elektrike | 22 |
| 5. | Konsumi i energjisë elektrike nga kategoria konsumator familjar në Shqipëri..... | 23 |
| 5.1 | Peshat e konsumatorit familjar në raport me konsumin total..... | 23 |
| 5.2 | Profili i konsumit të energjisë elektrike | 24 |
| 5.3 | Kërkesa për përdorim të fashës pa ndryshim çmimi deri në 800kwh | 25 |
| 6. | Sjellja e konsumatorit | 25 |
| 6.1 | Sjellja njerezore..... | 28 |
| 6.2 | Sjellje e ndërgjegjshme/vullnetare (bazuar në Teorinë e Sjelljes së Planifikuar (TPB)) 29 | |
| 6.3 | Sjellja me bazë sociale/kulturore..... | 29 |
| 6.4 | Sjellja sistemike / e mësuar | 30 |
| 7. | Sistemet e monitorimit të energjisë..... | 31 |
| 7.1 | Sistemi i monitorimit me dy drejtime | 33 |
| 7.2 | Konkluzione për sa më sipër | 33 |

| | |
|--|----|
| 8. Konsideratat për zhvillimin e mëtejshëm të Matjes Smart dhe përdorimin e përgjithshëm të njohurive të sjelljes në politikat publike. | 37 |
| 8.1 Konsiderata teknologjike..... | 38 |
| 8.2 Konkluzione | 38 |
| Gjetjet paraprake të ERE dhe rekomandimet e saj | 39 |
| Masat organizative | 42 |
| Rekomandime të ERE për marrjen e Masave Teknike sipas gjetjeve nga ky studim vlerësues | 43 |

Përmbledhëse figurave

| | |
|---|----|
| FIGURA 1 KONSUMI TOTAL I ENERGJISË ELEKTRIKE NË VEND NDËR VITE. | 20 |
| FIGURA 2 KONTRIBUTET E PRODHIMIT NETO VENDAS DHE BALANCËS IMPORT-EKSPORT NË KONSUMIN TOTAL TË ENERGJISË ELEKTRIKE NË SHQIPËRI | 21 |
| FIGURA 3 KLIENTËT FAMILJARË KUNDREJT KONSUMIT TOTAL TË VENDIT NË VITE (BURIMI: FSHU SHA..... | 22 |
| FIGURA 4 KONSUMI FAMILJAR NDAJ TOTALIT TË KONSUMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NE RANG VENDI | 23 |
| FIGURA 5 KONSUMI MESATAR DITOR PËR ÇDO MUAJ TË VITIT 2021, KRAHASUAR ME TË DHËNAT MESATARE TË PERIUDHËS 2009 - 2020 | 25 |
| FIGURA 6 KONSUMI I FATURIMIT 2017-2020 | 35 |

Përmbledhëse tabelave

| | |
|---|----|
| TABELA 2 METODOLOGJIA E LLOGARITJES..... | 10 |
| TABELA 3 REFERUAR CENSUSIT TË ZHVILLUAR NË VITIN 2011 TË ZHVILLUAR NË 6 QARQE TË REPUBLIKËS | 11 |
| TABELA 4 KONSUMI I ENERGJISË ELEKTRIKE NË NJË FAMILJE ME NIVEL..... | 12 |
| TABELA 5 KONSUMI MESATAR VJETOR NË KONSUMATORËT FAMILJAR NË ITALI | 13 |
| TABELA 6 KONSUMI MESATAR I ENERGJISË ELEKTRIKE NË FAMILJE PËR DISA SHTETE TË AMERIKËS | 15 |
| TABELA 7 PRODHIMI NETO VENDAS PËR VITIN 2021 | 18 |
| TABELA 8 PRODHIMI NETO VENDAS HISTORIK PËR PERIUDHËN 2009-2021 NË RAPORT ME MESATAREN E PRODHIMIT PËR KËTË PERIUDHË | 19 |
| TABELA 9 KONTRIBUES PËR ENERGJINË E PËRDORUR NË VITIN 2021 | 20 |
| TABELA 10 SHPËRNDARJA E KLIENTËVE TË OSSH SH.A SIPAS RAJONEVE DHE KATEGORIVE 2021 (BURIMI: OSSH SH.A.) | 22 |

1. Hyrje

Energjia elektrike zë një vend shumë të rëndësishëm në çdo familje duke qënë një kontribues i madh në përmirësimin e standardit të jetesës së çdo individi, dhe shoqërisë në përgjithësi. Ky dokument synon të paraqesë të dhëna mbi konsumin mesatar të energjisë elektrike, në periudhën 2010 - 2021 tek konsumatorët familjarë.

Faktorët që ndikojnë në sjelljen e konsumatorëve në raport me konsumin e energjisë elektrike janë konsideruar bazuar në të dhënat e publikura nga organizma të ndryshëm shtetërorë dhe organizata me fokus zhvillimet në tregjet e energjisë. Rezultatet nga studimi tregojnë për një përfshirje gjithnjë e më të madhe të mjeteve të teknologjisë, përdorimi i të cilave kërkon furnizim të vazhdueshëm me energji elektrike. Përdorimi i pajisjeve më efçente në konsumin e energjisë elektrike është një tjetër koncept që ka gjetur aplikim tek konsumatorët.

Konsumi i energjisë elektrike ka treguar një tendencë në rritje vit pas viti çka bën të nevojshme marrjen e masave për të mbajtur një ekuilibër midis furnizimit me energji elektrike dhe rritjes së kërkesës, si rritja e niveleve të kursimit të energjisë në lidhje me përdorimin e pajisjeve elektrike në shtëpi.

E njëjta tendencë raportohet edhe në shume vende të tjera në Europë. Referuar INSTAT konsumatorët shqiptar përdorin gjithnjë e më shumë pajisje dixhitale apo teknologji të reja.

Në këtë studim është vlerësuar edhe sjellja konsumatore në raport me Smart Meter por edhe në raport me monitorimin.

Roli i Smart meter

Roli i informimit

1.1 Qëllimi i Studimit

Konsumi i energjisë elektrike është një çështje komplekse që mund të shpjegohet me një kombinim të karakteristikave teknologjike, demografike, klimatike dhe të efçensës së ndërtesave dhe sjelljes konsumatore. Nëpërmjet këtij studimi synohet identifikimi i faktorëve të lidhur me konsumin e energjisë elektrike për të kuptuar kështu dhe tendencën e konsumit në kategorinë e konsumatorëve familjarë.

Qëllimi i këtij studimi është të analizojë perceptimet e konsumatorëve dhe sjelljet e tyre rreth kursimit të energjisë elektrike në lidhje me përdorimin e pajisjeve shtëpiake ku si bazë shërbejnë kryesisht sjelljet e orientuara nga zakoni. Nëpërmjet një pasqyrimi të faktorëve që ndikojnë në konsumin e energjisë synohet ndërgjegjësimi i konsumatorëve me qëllim të kuptuarin e:

- ✓ Përdorimit të energjisë elektrike në mënyrë efçente;
- ✓ Ndikimit të informacionit mbi zgjedhjen e pajisjeve efçente të kursimit të energjisë.

Në këtë studim synohet të përcillen gjetjet mbi faktorët tipik që prekin sjelljen e konsumatorëve në përdorimin e energjisë elektrike në Shqipëri.

Disa nga dimensionet kryesore të lidhura me tendencat në konsumin përfundimtar të energjisë u identifikuan nga Komisioni Evropian të cilat përfshijnë:

- ✓ Moti. Faktori i motit kishte një ndikim kryesisht në sektorët ku ngrohja dhe ftohja janë më relevante si rezidenciale dhe shërbime, kjo e fundit në një masë më të vogël.
- ✓ Rritja ekonomike. Rritja ekonomike si faktor në rritje që nga viti 2014 ka rritur nivelet e konsumit të energjisë. Rritja ekonomike kishte më shumë ndikim në sektorët e shërbimeve dhe transportit dhe në një masë më të vogël, në sektorin e industrisë. Gjatë periudhave të mëparshme, me ritme më të ulëta të rritjes ekonomike, fitimet e efijencës së energjisë ishin mjaft të mëdha për të kompensuar presionin lart në konsumin e energjisë nga rritja e aktivitetit ekonomik.
- ✓ Ndikimi dhe efektiviteti i politikave të efijencës së energjisë.

Sektori i banimit përbën rreth 1/4 e konsumit final të energjisë së BE-së. Konsumi në sektor u rrit me 7.4% midis 2014 dhe 2016, por ishte ende 3.1% nën mesataren për dekadën e mëparshme.

1.2 Metodologjia e mbledhjes së të dhënave

Për qëllime të këtij studimi janë përpunuar të dhënat e siguruara nga raportimet periodike të FSHU, institucionet shtetërore, organizmat ndërkombëtare si dhe raportet vjetore të ERE.

Kjo metodë mund të na ndihmojë të hetojmë faktorët e konsumit të energjisë elektrike në konsumatorët familjarë dhe ndikimit të sjelljes konsumatore.

2. Vështrim i përgjithshëm

Duke qenë se energjia elektrike në kohën e sotme përfaqëson një produkt të mënyrës së ekzistencës së shoqërisë njerëzore, si e tillë është shumë e kërkuar dhe shumë e çmuar nga të gjitha kategoritë e jetës dhe veprimtarisë njerëzore, përdorimi racional dhe me efijencë të lartë i saj është gjithashtu shprehje e veprimit të efektit rregullator.¹

Kontinenti evropian po përballet me një krizë të paprecedentë energjetike. Shkaku kryesor i krizës është:

- a) **Një rikthim nga ngadalësimi ekonomik gjatë pandemisë COVID-19.** Çentralet energjetike që u mbyllën gjatë pandemisë për shkak të reduktimit të kërkesës nuk mund të riktheheshin menjëherë në kohën e duhur në operim për të përmbushur kërkesën e rinovuar.
- b) **Pushtimi rus i Ukrainës në shkurt 2022 e përkeqësoi më tej situatën.** Si sanksionet evropiane, ashtu edhe hakmarrja ruse zvogëluan furnizimet e gazit natyror rus, duke i shtyrë çmimet e gazit në Evropën kontinentale në më shumë se 10 herë vlerat mesatare të tyre historike.
- c) **Kësaj shtohet edhe problemi me Francën, që nga një “eksportues i madh” i energjisë elektrike me kosto të ulët falë energjisë së saj bërthamore,** Franca nga vjeshta 2021 e në vazhdim është përballur me disa probleme që lidhen me elementët strukturorë të termocentraleve bërthamore që zotëron.

¹ [Studimi Konsumi i Energjisë Elektrike në Familje 4.09.2009.pdf \(ere.gov.al\)](#)

2.1. Masat e kursimit të energjisë elektrike në vendet Evropiane

Në nivelin e vendeve të Bashkimit European (BE), janë prezantuar një sërë instrumentesh për të mbështetur:

- ✓ **Përdorimin efikas të energjisë**, duke përfshirë nga pajisjet që përdorim deri te ndërtesat ku jetojmë dhe punojmë.
- ✓ **Përkufizimin gjerësisht si të përdorim më pak energji për të kryer të njëjtën detyrë ose për të prodhuar të njëjtin rezultat**, energji efikasiteti është një element kyç në politikën energjetike të BE-së.
- ✓ **Veçanërisht në realitetet aktuale gjeopolitike dhe të tregut të energjisë**, masat strukturore të efijencës së energjisë janë një nga mënyrat më të lehta dhe më ekonomike për të reduktuar përgjithmonë konsumin e përgjithshëm të energjisë në BE, për të rritur sigurinë e saj energjetike dhe për të dekarbonizuar sistemin e saj energjetik.
- ✓ **Në fokus të kursimit të energjisë** janë jo vetëm përpjekjet e koordinuara në nivel lokal, kombëtar dhe të BE-së por gjithashtu dhe **pjesëmarrja aktive e qytetarëve**, një masë po aq e nevojshme për të siguruar një vendosje të shpejtë dhe efektive të masave të efijencës së energjisë, të cilat shpesh shoqërohen me veprime të kursimit të energjisë për të maksimizuar ndikimin e tyre të dobishëm.²

Komisioni Evropian publikoi në maj te vitit 2022 planin e BE-së 'Kurseni Energjinë' si pjesë e planit REPowerEU³. Në këtë plan prezantohen masat afatmesme dhe afatgjata të efikasitetit të energjisë në sektorë kyç, si familjet, shërbimet, transporti dhe lëvizshmëria, që vendet e BE-së mund të marrin për të rritur kursimet e energjisë.

Në mbështetje të këtyre përpjekjeve, u zhvillua fushata e përbashkët e Komisionit-IEA *'Duke luajtur rolin tim'*. *Ky projekt ofroi disa hapa kyç që individët dhe kompanitë mund të ndërmarrin për të reduktuar konsumin e tyre të energjisë.* Së fundmi, Komisioni ka propozuar gjithashtu rregulla të reja për të ndihmuar në uljen e faturave të energjisë së konsumatorëve dhe bizneseve. Ndër të tjera, **propozimi sugjeron që të gjitha vendet e BE-së të ulin kërkesën e tyre të përgjithshme për energji elektrike me 10% deri në fund të marsit 2023, veçanërisht gjatë orëve të pikut, kur çmimi është në nivelin më të lartë.** Rritja e efijencës së energjisë do të jetë çelësi për arritjen e këtyre objektivave.

Në planin e veprimit të RE Power Eu theksohet se, ***kursimi i energjisë është mënyra më e lirë, më e sigurt dhe më e pastër për të reduktuar varësinë e Bashkimit European nga importet e karburanteve fosile nga Rusia. Të gjithë mund të përfshihemi lehtësisht në reduktimin e konsumit tonë të energjisë,*** nga konsumatorët dhe bizneset në të gjithë sektorët industrialë. Së bashku me masat e efijencës së energjisë, veprimet tona individuale do të kenë një ndikim pozitiv në çmimet - duke ulur drejtpërdrejt faturat tona të energjisë, duke e bërë ekonominë tonë më elastike dhe duke përshpejtuar tranzicionin e energjisë së pastër në BE.

² [In focus: Energy efficiency – a driver for lower energy bills | European Commission \(europa.eu\)](#)

³ [REPowerEU: affordable, secure and sustainable energy for Europe | European Commission \(europa.eu\)](#)

2.2. Mënyrat për të reduktuar konsumin e energjisë në jetën tonë përditshme, përfshijnë:

- *Ulja e temperaturës së ngrohjes ose përdorimin më pak i ajrit të kondicionuar*
- *Përdorimin më efikas të pajisjeve shtëpiake*
- *Reduktimet më ekonomike*
- *Kalimin më shumë në transport publik dhe lëvizshmëri aktive*
- *Fikjen e dritave*

Të gjithë përdoruesit e energjisë duhet të jenë të vetëdijshëm për mundësitë më të mira të kursimit dhe hapat më efektivë që mund të ndërmarrin.

3. Situata në Shqipëri e përdorimit të energjisë nga konsumatorë familjarë

3.1 Shërbimet kryesore familjare që përdorin energjinë elektrike

Në Shqipëri ecuria e konsumit familjar të energjisë elektrike nga viti 1992 e në vazhdim, ka një zhvillim tipik dhe mjaft karakteristik, që lidhet:

- *Në radhë të parë me ndryshimin dramatik të strukturës së përgjithshme të konsumit të energjisë elektrike nga sektorët e ndryshëm të jetës ekonomiko-sociale të vendit, si industria, bujqësia, shërbimet etj. Ky ndryshim shpërthyes u kushtëzua para së gjithash nga ndryshimi i sistemit politik, i cili solli si pasojë përmbyshjen e strukturës ekzistuese të konsumit të energjisë elektrike në vitet 1991-1992.*

Në studimin e Decon (kompani gjermane) të vitit 2003 i bëhet një analizë e hollësishme faktorëve që çuan në rritjen e jashtëzakonshme të kërkesës së konsumit të energjisë elektrike në familje.

Kështu mund të përmenden si më tipike:

- ✓ **Uria e madhe e popullatës për pajisje elektro - shtëpiake** të nevojës së parë si frigoriferë, makina larëse, pajisje audiovizive, ngrohës uji elektrik etj, mbasi për shkak të izolimit të përgjithshëm të vendit nga regjimi totalitar dhe nivelit të ulët të të ardhurave për familje, për këto pajisje kishte një mungesë të madhe.
- ✓ **Nga ana tjetër, çmimi i ulet i energjisë elektrike, vjedhjet e saj, arkëtimet e ulëta dhe në këto rrethana përdorimi në shkallë të gjerë i energjisë elektrike për ngrohje banese, ishin faktorë që përshpejtuan në limitet e skajshme kërkesën për energji elektrike nga konsumatorët familjarë.**
 - **Shërbimet që sigurohen përmes energjisë elektrike dhe kanë gjetur përdorim për plotësimin e nevojave në familjet e vendit tonë mund të themi se janë të njëjta me ato që përdoren edhe në vendet e zhvilluara të Evropës dhe të botës. Edhe *në vendin tonë përdorimi i energjisë elektrike nga konsumatori familjar sikundër edhe në vendet e***

zhvilluara të botës është mënyrë ekzistence, ajo shërben njëkohësisht për plotësimin e nevojave jetike si dhe të nevojave të tjera social kulturore.

3.2 Fushat e përdorimit të energjisë elektrike në familje në vendin tonë si dhe disa tregues specifikë që përcaktojnë dhe një farë individualiteti të natyrës së këtij përdorimi.

1. Për ndriçimin elektrik të banesës.

Në Shqipëri 100% e familjeve në qytet dhe në fshat ndriçohen me energji elektrike. Fillimisht ai ka qene e tipit inkandeshent dhe vitet e fundit ai po miksohet duke përdorur ndricimin LED, kjo kryesisht në zonat Urbane.

2. Për gatim familjar

Sipas studimit të Decon etj., deri në vitin 2001, **80 % e familjeve gatuanin me energji elektrike.** Kemi mendimin se në ditët e sotme për shkak të penetrimit më të madh të pajiseve elektroshtepiake , falë reduktimve të përdorimit të llojeve të ndryshme , për fat të keq nuk disponohen të dhëna koherente për të përligjur një hipoteze të tillë.

3. Në zonat urbane, ngrohja e ujit

Sikurse dihet në vendin tonë ndarja e zonave është urbane ,rurale dhe rurale e thellë. Për nevoja sanitare në familje ngrohja e ujit kryhet me ngrohësa elektrikë (bojler elektrik) të standardizuar. Në zonat rurale kjo metodë përdoret në një shkallë më të vogël. Mungesa e sistemeve të ngrohjes së çentralizuar të banesës ka bërë që të përdoret më shumë metoda e decentralizuar e ngrohjes së ujit sanitar, e cila realizohet me një shkallë efijence më të ulët pra me një shpenzim me të madh energjie elektrike. Edhe shkalla e penetrimit të paneleve diellore termike për ujë të ngrohtë sanitar është aktualisht shumë e ulët dhe nëpërmjet tyre përftohet vetem 1 – 1.5 % e energjisë së përgjithshme që përdoret për ngrohje uji. Në zonat rurale përdoren edhe mënyrat e thjeshta të ngrohjes së ujit sanitar si ajo me dru zjarri.

4. Për ngrohjen dhe freskimin e banesës

Gjatë 10 viteve të fundit është rritur përdorimi për ngrohje i pompave të nxehtësisë (kondicionerëve) që kanë rendiment termik më të lartë. Një tipar karakteristik i kësaj mënyre ngrohëse të banesës është ngrohja e pjesshme e saj dhe jo ngrohja tërësore sikurse realizohet me sistemet e përqëndruara. Sistemet e përqëndruara janë të instaluar kryesisht në apartamentet e reja te cilat zënë një përqindje të ulët në vendin tonë.

Për freskimin e banesës. Kushtet klimatike të vendit tonë, me verë shumë të nxehtë dhe të thatë, kanë bërë që vitet e fundit të rriten nivelet e përdorimit të kondicionerëve për freskim të banesës. Prania e tyre ndikon në profilin e grafikut të ngarkesës për stinën e verës, me një rritje vit pas viti të konsumit ditor të energjisë elektrike në shkallë vendi. **Sot kondicionerët përbëjnë një faktor me ndikim në analizën e konsumit familjar të energjisë elektrike.** Konsumi i energjise elektrike për kondicionimin është në varësi të hapsirës, të termoizolimit të ambientit ku ndodhet kondicioneri si dhe nga klasa e teknologjisë së kësaj pajisjeje, gjë për të cilën kihet parasysh në vlerësimin e saj sipas metodologjive përkatëse që shërbejnë për çdo pajisje elektroshtepiake .

5. Për ruajtjen e produkteve ushqimore me teknikën e ftohjes

Kjo teknikë ftohëse realizohet me anën e frigoriferëve familjar me kapacitete të ndryshme. **Aktualisht 100% e familjeve janë të pajisur me frigoriferë në zonat urbane dhe rreth 95% në ato rurale.** Frigoriferët e vendosur në përdorim pas vitit 2001 kanë tregues më të mirë të efijencës së përdorimit të energjisë elektrike. Klima e vendit ndikon në energjinë e konsumuar, gjatë stinës së verës, dhe për shkak të temperaturave të larta të stinës, ka një rritje deri në 20% të konsumit të energjisë elektrike.

6. Për larjen e rrobave me makina larëse elektrike

Sot në zonat urbane vetëm me ndonjë përjashtim të vogël, 100 % e familjeve përdorin për larjen e rrobave makinat larëse elektrike të tipeve dhe kapaciteteve të ndryshme, ndërsa në zonën rurale përdorimi i tyre shtrihet në masën deri në 70%. **Kufizimi i përdorimit më të madh në zonat rurale lidhet me kapacitetet ende të limituara të rrjeteve të furnizimit me ujë të rrjedhshëm në këto zona.**

7. Për informimin dhe edukimin viziv me televizion

Sot, pothuajse 100% e familjeve shqiptare, përdorin për informim dhe edukim kulturor e zbavitje televizorin me ngjyra të tipeve dhe madhësive të ndryshme.

8. Për mjediset e përbashkëta në pallatet e banimit me disa apartamente

Në këtë kategori shërbimi bën pjesë ndriçimi elektrik i shkallëve, furnizimi me energji elektrike i ashensorëve, pompave të përbashkëta të ujit etj, që mesatarisht kanë një konsum mesatar prej 20-25 kwh/muaj

9. Për pajisje të tjera

Në këtë grup pajisjesh elektroshëpiake bëjnë pjesë:

- Hekuri për hekurosje rrobash;
- Ventilatorët për freskim mjedisi;
- Fshesat elektrike;
- Furrat me mikrovalë;
- Tharëset elektrike të flokëve;
- Ekspresët e kafesë;
- Kombinati i kuzhinës;
- Brumatricet elektrike familjare (makina e bukës);
- Pajisjet për thekjen e bukës;
- Tostet për hamburger;
- Jastëkët dhe jorganët termo-elektrik.

Pjesa e konsiderueshme e përdorimit të energjisë në shtëpi është për ngrohje dhe ajër të kondicionuar, e cila ka dhe peshën specifike me te madhe

Familjet shqiptare kanë nevojë për energji për të fuqizuar pajisje të shumta shtëpiake, por mesatarisht, **37 % pjesë e konsumit vjetor të energjisë së një familjeje është vetëm për dy përdorime përfundimtare të energjisë: ngrohjen e hapësirës dhe klimatizimin.** Këto përdorime kryesisht sezonale dhe me energji intensive ndryshojnë ndjeshëm sipas vendndodhjes gjeografike, madhësisë dhe strukturës së shtëpisë, si dhe pajisjeve dhe lëndëve të përdorura.

Ngrohja e ujit, ndriçimi dhe ftohja janë përdorime pothuajse universale të energjisë gjatë gjithë vitit në shtëpi. Këto tre përdorime përfundimtare të kombinuara përbënin 27% të përdorimit të përgjithshëm vjetor të energjisë në shtëpi.

Pjesa e mbetur – 36% – e përdorimit të energjisë në shtëpi janë për pajisje të tilla si televizorët, pajisjet e gatimit, larëset e rrobave dhe tharëset e rrobave, si dhe një listë në rritje e pajisjeve elektronike të konsumit duke përfshirë kompjuterët, tabletët, telefonat inteligjentë, konsolat e lojërave video dhe internetin, pajisjet e transmetimit.

Nga një vlerësim mesatar i formateve projektuese që kryejnë aplikantët për përdorim për konsum të energjisë elektrike dhe metodologjisë së llogaritjes të miratuar, ajo është si në grafikun e mëposhtëm:

Tabela 1 Metodologjia e llogaritjes

| Paisjet | Konsumi ditor | Perdorim mujor | Konsumi mujor | Konsumi Vjetor | Pesha specifike |
|--|---------------|----------------|---------------|----------------|-----------------|
| Frigorifer | 1.1 | 30 | 33 | 396 | 4% |
| Lavatriçe | 6 | 10 | 60 | 720 | 7% |
| Pjatararëse | 1.8 | 30 | 54 | 648 | 7% |
| Boiler | 5 | 30 | 150 | 1800 | 19% |
| Kondicionimi | 10 | 30 | 300 | 3600 | 37% |
| Sobe elektrike | 4.5 | 30 | 135 | 1620 | 17% |
| Televizor | 0.3 | 30 | 9 | 108 | 1% |
| Ndricim mix | 0.97 | 30 | 29.1 | 349.2 | 4% |
| Hekur, fshesë, kompjuter, DVD etj | 1 | 30 | 30 | 360 | 4% |
| Totali | 30.67 | | 800.1 | 9601.2 | 100% |

3.3 Faktorët që ndikojnë në sasinë e energjisë elektrike që përdor një familje

Një sërë faktorësh ndikojnë në sasinë e energjisë elektrike që përdor një familje, duke përfshirë:

- *Vendodhjen gjeografike dhe klimën;*
- *Llojin e shtëpisë dhe karakteristikat e saj fizike;*
- *Numrin, llojin dhe efikasitetin e pajisjeve që konsumojnë energji në shtëpi dhe sasinë e kohës që ato përdoren;*
- *Numrin e anëtarëve të familjes.*

Tabela 2 Referuar Censurit të zhvilluar në vitin 2011 të zhvilluar në 6 qarqe të Republikës kemi këto të dhëna:

| Qarku | Total individ | Ngrohje qendrore ne ndertese | Ngrohje qendrore ne ndertese | Ngrohje qendrore individuale ne banese | Ngrohje qendrore individuale ne banese | Oxhak | Oxhak | Ngrohes elektrike | Ngrohes elektrike | Kondicion er | Kondicion er | Lloj tjetet ngrohje | Lloj tjetet ngrohje | Pa ngrohje | Pa ngrohje |
|---------------|---------------|------------------------------|------------------------------|--|--|-------|-------|-------------------|-------------------|--------------|--------------|---------------------|---------------------|------------|------------|
| Qarku Tirane | 196218 | 3075 | 2% | 5040 | 3% | 3250 | 2% | 31080 | 16% | 29193 | 15% | 27771 | 14% | 13827 | 7% |
| Qarku Durrës | 66650 | 758 | 1% | 2166 | 3% | 2165 | 3% | 3890 | 6% | 3108 | 5% | 10566 | 16% | 3224 | 5% |
| Qarku Elbasan | 73044 | 448 | 1% | 653 | 1% | 1545 | 2% | 2839 | 4% | 1528 | 2% | 1638 | 2% | 2299 | 3% |
| Qarku Fier | 82074 | 987 | 1% | 1446 | 2% | 4721 | 6% | 7868 | 10% | 2013 | 2% | 7244 | 9% | 9459 | 12% |
| Qarku Vlorë | 50961 | 665 | 1% | 1798 | 4% | 9678 | 19% | 7464 | 15% | 3410 | 7% | 5370 | 11% | 8289 | 16% |
| Qarku Shkoder | 54429 | 666 | 1% | 706 | 1% | 3279 | 6% | 969 | 2% | 1031 | 2% | 3632 | 7% | 1049 | 2% |

Referuar vlerësimeve të kërkesës për konsum nga ana energjetike e OSSH për shkak të kërkesës më të lartë për ngrohjen e hapësirës, familjet në zonat Perëndimore dhe Qëndrore në Shqipëri nga disa përlllogaritje të përafërta konsumojnë mesatarisht më shumë energji sesa familjet në zonat verilindore (përdorimi i lëndës drusore).

Në Shqipëri si pasojë e lëvizjeve demografike, zona perëndimore (duke filluar nga Velipoja e deri në Ksamil referuar regjimit të punës të rrjetit shpërndares të OSSH sha,) ka rreth 70% të kërkesës për konsum dhe zona lindore ka rreth 30% të kërkesës për konsum te energjise elektrike.

Familjet në shtëpi të mëdha dhe familjet më të mëdha priren të përdorin më shumë energji në përgjithësi se sa shtëpitë e vogla dhe familjet më të vogla.


Ngrohja e hapësirave dhe ajri i kondicionuar zënë një pjesë shumë më të vogël të përdorimit të energjisë elektrike për nevoja shtëpiake në apartamente sesa në shtëpitë e ndara me një familje. Apartamentet janë përgjithësisht më të vogla se shtëpitë e një familjeje, dhe ato shpesh janë pjesërisht të izoluara nga moti nga apartamentet ngjitur. Një familje mesatare që jeton në një shtëpi të veçuar për një familje konsumon gati tre herë më shumë energji sesa një familje që jeton në një ndërtesë apartamentesh që ka pesë ose më shumë apartamente. Të dhënat mbi shkallën e përdorimit të pajisjeve elektro-shtëpiake në shkallë vendi janë nxjerrë nga një studim i Decon duke bërë dhe disa korrektime nga burime të tjera si ajo e kërkesave të aplikantëve për përdorimin e energjisë elektrike në përputhje me rregulloren e lidhjeve të reja të miratuar nga ERE.

3.4 Llogaritja e konsumit të energjisë për konsumatorë familjarë

Le të analizojmë konsumatorin fundor. Konsumi i energjisë elektrike në një familje me nivel mesatar me pajisje elektro-shtëpiake si më poshtë:

Tabela 3 Konsumi i energjisë elektrike në një familje me nivel mesatar dhe me kërkesa për një jetese normale

| Paisjet | Konsumi ditor (kwh) | Përdorim mujor (ditë) | Konsumi mujor (kwh) | Konsumi Vjetor (kwh) | Pesha specifike (%) |
|------------------------|---------------------|-----------------------|---------------------|----------------------|---------------------|
| Frigorifer | 1 | 30 | 30 | 360 | 4% |
| Lavatrice | 5.1 | 10 | 51 | 612 | 7% |
| Pjatarëse | 1.6 | 30 | 48 | 576 | 6% |
| Boiler (dush) | 4.8 | 30 | 144 | 1728 | 18% |
| Kondicioner | 9.8 | 30 | 294 | 3528 | 38% |
| Sobe elektrike | 4.3 | 30 | 129 | 1548 | 17% |
| Televizor | 0.24 | 30 | 7.2 | 86.4 | 1% |
| Ndricim mix | 1.3 | 30 | 39 | 468 | 5% |
| Hekur, fshesë, PC, etj | 1.26 | 30 | 37.8 | 453.6 | 5% |
| Totali | 29.4 | | 780 | 9360 | 100% |




4. Konsumi i energjisë në shtete të ndryshme

Bazuar tek të dhënat e grumbulluara, me poshtë po paraqesim disa tabela të konsumit të energjisë sipas shteteve të ndryshme.

4.1 Konsumi mesatar vjetor në konsumatorët familjar në Itali:

Tabela 4 Konsumi mesatar vjetor tek konsumatorët familjare në Itali

| Konsumi mesatar vjetor i energjisë sipas tipit te pajisjes ne një familje ne Itali | | | | | |
|--|------------|--|---------------------------------|------------|-----------------|
| Paisja | Fuqia ne W | Perdorimi | Konsumi vjetor I matur ne (kWH) | Mujor | Pesha specifike |
| pjatolarëse | 3000 | 5 herë në javë | 580 | 48.33 | 8.94 |
| boiler | 2500 | rreth 700 litra në javë 50 gradë Celsius | 1900 | 158.33 | 29.3 |
| sobe | 9600 | 1 herë në ditë për drekë, 1 herë në javë piqni një tortë | 610 | 50.83 | 9.41 |
| | | | | - | 0 |
| ngrohes elektrik | 2000 | periodicisht | 730 | 60.83 | 11.26 |
| ngrires 150 litri | 150 | vazhdimisht | 600 | 50.00 | 9.25 |
| boiler I vogel 5 litri | 2000 | 15 litra uje te nxehte | 280 | 23.33 | 4.32 |
| drita | 40-60 | 180 Watt per 3-4 ore/ne dite | 250 | 20.83 | 3.85 |
| lavatrice | 3300 | 4 herë në javë | 320 | 26.67 | 4.93 |
| tharese | 2600 | 4 herë në javë | 450 | 37.50 | 6.94 |
| frigorifer 120 litri | 120 | vazhdimisht | 400 | 33.33 | 6.17 |
| aspirator | 190 | 1 orë në ditë | 70 | 5.83 | 1.08 |
| televizore me ngjyra | 100 | 3 ore ne dite | 110 | 9.17 | 1.7 |
| makine kafeje | 750 | 8 gota ne dite | 50 | 4.17 | 0.77 |
| radio | 20 | 2 ore ne dite | 15 | 1.25 | 0.23 |
| tharese flokesh | 400 | 4 here ne jave | 30 | 2.50 | 0.46 |
| fshese me korrent | 1000 | 2 tapeta ne jave | 30 | 2.50 | 0.46 |
| hekur | 1000 | 4 kg larje ne jave | 50 | 4.17 | 0.77 |
| mixer | 120 | 10 minuti ne dite | 10 | 0.83 | 0.15 |
| makine rroje elektrike | 10 | 5 minuti ne dite | 0.3 | 0.03 | 0 |
| furce dhemebesh elektrike | 2 | 8 here 2 minuti ne dite | 0.2 | 0.02 | 0 |
| | | SHUMA | 6,486 | 540 | 100 |



4.2 Konsumi i energjisë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës - ShBA

Shifrat e fundit, që nga viti 2020, tregojnë se konsumi mesatar vjetor i energjisë elektrike për një klient të shërbimeve rezidenciale në SHBA është 10,715 kilovatorë (kWh). Nëse pjestohet kjo shifër me 12 muaj, konsumi mesatar mujor i energjisë elektrike është 890 kWh në muaj. Po në një ditë të vetme? Kjo do të ishte 10,715 kWh e ndarë me 365, ose 29 kWh. Atëherë konsumi mesatar ditor i energjisë elektrike është 29 kWh.

Le të marrim përdorimin e menjëhershëm të energjisë elektrike.

Numri i orëve në një vit është 365 ditë x 24 orë = 8760 orë.

Atëherë mesatarisht, në çdo kohë, shtëpia përdor 10,715 pjesëtuar me 8760 orë, që është 1,22 kilovat. Nevojat për energji të një shtëpie në çdo moment atëherë janë mesatarisht 1.22 kilovat. Por për të qenë të drejtë, ka luhajtje të rënda dhe të lehta të ngarkesës. Dhe shumica e përdorimit të energjisë ndodh gjatë orëve të zgjimit. Një përafrim më i mirë është të thuhet se përdorimi i energjisë ndodh vetëm gjatë ditës. Kjo rrit konsumin e menjëhershëm të energjisë deri në 2.44 kilovat.

| Frekuenca | Përdorimi për familje (kwh = kilovat orë) |
|----------------|---|
| Ditore | 29 kWh |
| Mujore | 890 kWh/ |
| vjetore | 10,715 kWh/ |
| E menjëhershme | 1-3 kW (kilovat) |

Konsumi i energjisë elektrike i familjeve të kombinuara amerikane


Duke përdorur numrat për një familje të vetme, ekspertët e fushës kanë llogaritur konsumin e energjisë elektrike të të gjitha familjeve amerikane së bashku. Ky do të jetë një numër i madh. Nga VNM-ja vërejmë se numri total i klientëve rezidencialë është 123 570 370. Klient për një shoqëri komunale nënkupton një familje. Pra janë 123.570.370 familje

Tabela 5. Konsumi mesatar i energjisë elektrike në familje për disa shtete të Amerikës


| State | Electricity use per household per month (KWH) |
|----------------|---|
| Mississippi | 1146.33 |
| Montana | 858.24 |
| North Carolina | 1040.83 |
| North Dakota | 1085.26 |
| Nebraska | 1013.19 |
| New Hampshire | 622.41 |
| New Jersey | 673.24 |
| New Mexico | 669.89 |
| Nevada | 970.67 |
| New York | 599.78 |
| Ohio | 888.02 |
| Oklahoma | 1078.20 |
| Oregon | 916.27 |
| Pennsylvania | 821.88 |
| Rhode Island | 598.93 |
| South Carolina | 1080.70 |
| South Dakota | 1036.73 |
| Tennessee | 1168.32 |
| Texas | 1131.93 |
| Utah | 768.85 |
| Virginia | 1095.21 |
| Vermont | 567.13 |
| Washington | 969.49 |
| Wisconsin | 694.24 |
| West Virginia | 1051.24 |
| Wyoming | 869.33 |



Në Australi



4.3 Konsumi i energjisë për ndriçim ne Evropë



4.4 Prodhimi i energjisë elektrike për vitin 2021 në Shqipëri (Referenca nga raporti vjetor i ERE për vitin 2021)

Prodhimi total neto vendas i energjisë elektrike i realizuar për vitin 2021 ishte **8,962,699 MWh**, nga i cili:

- **5 343 974 MWh** u prodhuan nga centralet në zotërim të kompanisë publike KESH sh.a.
- **3 618 725 MWh** u prodhuan nga centrale të tjera.

Prodhimi i energjisë elektrike i realizuar për vitin 2021 nga KESH sh.a. zë 59.6 % të gjithë prodhimin të energjisë elektrike në vendin tonë dhe prodhimi i energjisë elektrike nga prodhuesit e tjerë zë rreth 40.4 %.


Në të njëjtën kohë në figurën më poshtë paraqitet prodhimi neto vendas për vitin 2021, duke evidentuar kontributin në prodhimin e energjisë elektrike të KESH sh. a, si prodhues publik si dhe kontributet e prodhuesve të tjerë. Prodhimi i realizuar nga kompania publike KESH sh. a, vazhdon të ketë peshën kryesore në prodhimin vendas edhe përgjatë vitit 2021.

Tabela 6 prodhimi neto vendas për vitin 2021

| PRODHIMI NETO VENDAS 2021 (MWh) | 2021 |
|--|------------------|
| HEC-et / PPE ne rrjetin e OSSH sha | 877,726 |
| HEC-et / PPE ne rrjetin e OST sha | 951,505 |
| HEC-et e pavarur IPP ne rrjetin e OST sha | 1,425,989 |
| HEC Lanabregas | 27,504 |
| HEC Ashta | 295,245 |
| Centralet Fotovoltaike | 40,756 |
| Prodhimi nga HEC-et e KESH sha | 5,343,974 |
| TOTAL VENDAS 2021 | 8,962,699 |

Burimi OST sha; KESH sha; FTL sha

Tabela 7 Prodhimi neto vendas historik për periudhën 2009-2021 në raport me mesataren e prodhimit për këtë periudhë



4.5 Veprimtaria e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike

Shpërndarja e energjisë elektrike në vendin tonë kryhet nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a.), i licencuar nga ERE sipas dispozitave të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ka në pronësi asetet në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike, me qëllim lëvrimin e energjisë elektrike tek klientët. Kufiri i sistemit të shpërndarjes me sistemin e transmetimit është i përcaktuar në ligjin nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar.

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) është përgjegjës për sigurimin e zhvillimit të sigurt dhe të qëndrueshëm të sistemit të shpërndarjes, përmbushjen e kërkesave për shpërndarjen e energjisë elektrike; mirëmbajtjen dhe operimin e sigurt të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike në gjithë territorin për të cilin është licencuar. Në përputhje me ligjin nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, OSSH sh.a. prokuron energji elektrike në tregun e hapur dhe nga burimet e rinovueshme, për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, në përputhje me rregulloren e miratuar nga ERE dhe nëpërmjet platformës elektronike për procedurat e blerjes së energjisë elektrike.

Konsumi total vjetor i Energjisë Elektrike (duke përfshirë edhe konsumin e klientëve në treg të parregulluar) në vendin tonë për periudhën nga viti 2004 deri në vitin 2021 paraqitet në mënyrë grafike si më poshtë:




Figura 1 Konsumi total i energjisë elektrike në vend ndër vite.

Siç vërehet në paraqitjen grafike, *konsumi më i ulët i energjisë elektrike i rregjistruar në vendin tonë është në vitin 2007 me 5,767,652 MWh dhe konsumi më i lartë i energjisë elektrike është ai i rregjistruar në vitin 2021 me 8,414,836 MWh*. Për vitin 2021 konsumi i energjisë elektrike në vendin tonë është konsumi me i lartë historik me 8,414,836 MWh

Tabela 8 Kontribues për energjinë e përdorur në vitin 2021

| Kontribues për energjinë përdorur në vitin 2021 | | | |
|---|-----------------------|--------------------------|------------------------------|
| Prodhues publik (KESH) | Prodhues me përparësi | Prodhues në treg të lirë | Balancim për interkonjeksion |
| 5,343,974 | 2,192,736 | 1,425,909 | 547,896 |
| | | 8,962,619 | |
| | | 8,414,723 | |
| 64% | 26% | | 7% |

Konsumi i energjisë elektrike total në vend përgjatë vitit 2021 është mbuluar nga gjenerimi i energjisë elektrike i realizuar nga KESH sh.a., Prodhuesit e Pavarur të energjisë elektrike, Prodhuesit me Përparësi të energjisë elektrike si dhe nga importi i energjisë elektrike.




Figura 2 Kontributet e prodhimit neto vendas dhe balancës Import-Eksport në konsumin total të Energjisë Elektrike në Shqipëri

Në tabelën e mesipërme evidentohet prodhimi neto vendas, dhe balanca import – eksport. Sikurse paraqitet në të dhënat e mesipërme prodhimi neto vendas **për vitin 2021 rezulton të jetë 8,963 GWh ndërkohë që konsumi total i vendit rezulton të jetë 8,415 GWh, me një balancë neto në drejtimin eksport 548 GWh**

| Kontribues ne konsumin e energjise te siguruar ne vitin 2021 | | | | |
|---|-------------------------------------|--------------------------|-------------------|---|
| Konsumi në treg të rregulluar | Klientë Konsumatorë të lidhur në TL | Prodhues në treg të lirë | Konsumator në FTL | Konsumuar nga OST (humbje + nevoja vetjake) |
| 7,054,114 | 1,049,953 | 64,916 | 17,935 | 227,918 |
| | | 8,414,836 | | |
| | | 8,396,901 | | |
| 84% | 13% | 1% | 0% | |

4.6 Struktura e Konsumit të Energjisë Elektrike

Tabela 9 Shpërndarja e Klientëve të OSSH sh.a sipas rajoneve dhe kategorive 2021 (Burimi: OSSH sh.a.)

| SHPËRNDARJA E KONSUMATORËVE SIPAS RAJONEVE DHE KATEGORIVE 2021 (%) | | | | | | |
|--|-------------|--------------|--------------|---------------|--------------|---------------|
| | Buxhetor | Familjare | Jo-Buxhetore | Konsum vetjak | Privat | 2021 |
| Berat | 0.08 | 7.11 | 0.03 | 0.00 | 1.12 | 8.33 |
| Burrel | 0.05 | 4.32 | 0.02 | 0.00 | 0.50 | 4.90 |
| Durres | 0.07 | 11.98 | 0.03 | 0.00 | 1.51 | 13.59 |
| Elbasan | 0.08 | 7.57 | 0.04 | 0.00 | 1.04 | 8.72 |
| Fier | 0.05 | 5.81 | 0.02 | 0.00 | 0.80 | 6.69 |
| Gjirokastr | 0.10 | 5.53 | 0.02 | 0.00 | 0.79 | 6.45 |
| Korce | 0.08 | 6.50 | 0.02 | 0.00 | 0.76 | 7.36 |
| Kukes | 0.03 | 1.47 | 0.01 | 0.00 | 0.18 | 1.69 |
| Shkoder | 0.08 | 7.86 | 0.03 | 0.00 | 1.12 | 9.08 |
| Tirane | 0.12 | 22.29 | 0.04 | 0.00 | 4.10 | 26.56 |
| Vlore | 0.04 | 5.72 | 0.02 | 0.00 | 0.86 | 6.64 |
| TOTAL | 0.78 | 86.17 | 0.26 | 0.02 | 12.77 | 100.00 |

Të dhënat e paraqitura më sipër tregojnë se numri i përgjithshëm i klientëve për vitin 2021 është 1 279 460. Dhe për vitin 2021 pjesën më të madhe të klientëve të FSHU sh.a. e zënë konsumatorët familjarë që shkojnë në 86.17 % të numrit total të konsumatorëve të FSHU sh.a.

Në figurën e mëposhtme paraqiten peshat specifike në faturim që zënë kategoritë e klientëve familjarë.




Figura 3 Klientët Familjarë kundrejt konsumit total të vendit në vite (Burimi: FSHU sha)

Konsumi i klientëve familjarë zë rreth 36.6 % të konsumit total

5. Konsumi i energjisë elektrike nga kategoria konsumator familjar në Shqipëri

5.1 Peshat e konsumatorit familjar në raport me konsumin total

Në figurën e mëposhtme paraqiten peshat specifike në faturim që zënë kategoritë e klientëve familjarë sipas raportit vjetor 2021 të ERE.

| 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 |
|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|
| 6,587 | 6,970 | 7,208 | 7,617 | 7,855 | 7,791 | 7,265 | 7,094 | 7,440 | 7,639 | 7,612 | 7,589 | 8,415 |
| 2,423 | 2,588 | 2,588 | 2,068 | 2,261 | 2,502 | 2,522 | 2,587 | 2,655 | 2,682 | 2,752 | 2,957 | 3,082 |
| 36.8% | 37.1% | 35.9% | 27.1% | 28.8% | 32.1% | 34.7% | 36.5% | 35.7% | 35.1% | 36.2% | 39.0% | 36.6% |





Figura 4 Konsumi familjar ndaj totalit të konsumit të energjisë elektrike në rang vendi

Konsumi i klientëve familjarë për vitin 2021 zë rreth 36.6% të konsumit total, shifër kjo më e ulët krahasuar me konsumin për të njëjtën kategori për vitin 2020, i cili ishte në masën 39%.

Referuar të dhënave të 9 mujorit të vitit 2022 kemi këtë tabelë të konsumit familjar.

| FASHA FAMILJAR | VITI 2022 (9 mujor) | | VITI 2022 (9 mujor) | |
|--------------------|----------------------|----------------------|-----------------------------|----------------------|
| | NR KONTRATA MESATARE | KWH TOTAL | Numri I kontratave VS total | Sasia e KWH VS Total |
| 0 | 251,280 | 0 | 22.70% | 0 |
| 1-800 | 815,497 | 1,829,365,599 | 73.65% | 80.23% |
| 801-5001+ | 40,433 | 450,679,431 | 3.65% | 19.77% |
| Grand Total | 1,107,210 | 2,280,045,030 | 100.00% | 100.00% |



5.2 Profili i konsumit të energjisë elektrike

Profili vjetor i konsumit të energjisë elektrike karakterizohet nga simetria thuajse e plotë e konsumit dimër – verë. Ashtu sikurse tek raportimet e viteve të mëparshme edhe këtë vit vërehet e njëjta dukuri, ajo e përdorimit të energjisë elektrike për ngrohje në dimër, por edhe për sistemet ftohëse në verë, elemente të cilat çojnë në simetrinë e konsumit të energjisë elektrike, si në periudhën e dimrit dhe atë të verës.

Çdo ndryshim i temperaturës së mjedisit reflektohet menjëherë në konsumin ditor të energjisë elektrike, pikërisht prej efektit të përdorimit ose mospërdorimit të ngrohjes/ftohjes me energji elektrike të banesës.

Gjatë stinës së verës, në muajt korrik dhe gusht, prirja e pikut është në rritje, i cili nga viti në vit po bëhet më i dukshëm dhe lidhet me ndryshimet klimatike dhe përmirësimin e kushteve të jetesës, që po çon në përdorimin gjithnjë edhe më të madh të pajisjeve klimatizuese gjatë muajve të nxehtë.

Më poshtë paraqiten të dhënat e konsumit mesatar ditor për çdo muaj të vitit 2021, krahasuar me të dhënat mesatare të periudhës 2009 - 2020.




Figura 5 konsumit mesatar ditor për çdo muaj të vitit 2021, krahasuar me të dhënat mesatare të periudhës 2009 - 2020

5.3 Kërkesa për përdorim të fashës pa ndryshim çmimi deri në 800kwh

Kjo kërkesë për konsum për sezonin dimëror 2021-2022 u plotësua me rritjen kapaciteteve transformuese dhe shpërndarëse në masën 15 % për ti paraprirë rritjes natyrale sipas normave të projektimit në masën 3%.

Faktikisht kërkesa për konsum këtë sezon dimëror ishte 12.8% gjë për të cilën ushtrohet ky propozim të rritjes së çmimit për klientët që konsumojnë në faturën mesatare mbi 800 kWh për të përballuar

- a) **Rritjen e çmimeve në bursë të energjisë, të materialeve me ngjyrë dhe ato izoluese të cilat janë dhe elementet bazë të artikujve që përdoren në infrastrukturën e energjise elektrike;**
- b) **Kërkesën për të përballuar kërkesën në rritje për konsum energjie;**
- c) **Kërkesën për të pasur një shkallë të lartë sigurie dhe qëndrueshmërie të sistemit të shpërndarjes në përputhje me kërkesat e ligjit 43/2015 i ndryshuar, kodit të shpërndarjes dhe akteve rregullative në fuqi;**
- d) **Për të përballuar kërkesat për investimet e menjëhershme emergjente për të qënë e aftë për të përballuar kërkesat në rritje për konsum në zonën perëndimore të Republikës në mënyrë të veçantë në rajonet Tiranë, Durrës, Shkodër, Vlorë, Fier, Gjirokastrë si zona tipike të zhvillimit të turizmit.**

6. Sjellja e konsumatorit

Statistikat fokusohen në kapacitetet Gjeneruese, Transmetuese dhe Shpërndarëse. Por konsumatori dhe kërkesa e tij për burimin e energjisë janë vendimtare për sistemin elektrik dhe ruajtjen e tij.

Në fakt, në Shqipëri ka më pak studime ku më e fundit është ajo e censurit të vitit 2011 për të parashikuar kërkesën e konsumatorit. (http://www.instat.gov.al/media/3069/11_tirane.pdf)

Sjellja e tyre vështirë se kuptohet përmes parashikimit të ngarkesës. ***Një furnizues i shpërndarjes lidh të gjithë konsumatorët - të varfërit me të pasurit, rurale me periferitë pastaj me urbanin, bujqësinë me kërkesë të ulët me industrinë me kërkesë të lartë etj.***

Punimi aktual synon të vlerësojë

- nëpërmjet sjelljes të konsumatorit jo vendas
- të dhënave të censusit 2011
- të disa mundësive të krijuara nga matësat SMART, nëpërmjet nxjerrjes së të dhënave të tyre për konsumin e energjisë elektrike të dy projekteve pilot të zhvilluara në, OSSh sh.a / OSHEE sh.a Group të disa mundësive të krijuara për të vlerësuar sjelljen e konsumatorit vendas në përgjithësi dhe atij familjar në veçanti.

Prandaj, ia vlen të ndalemi për t'i hedhur një vështrim këtij faktori për kursimin e energjisë elektrike dhe sjelljen e konsumatorit ndaj saj në vendin tonë.

Kursimi i energjisë elektrike mund të duket si një detyrë e vështirë për shkak të natyrës së energjisë elektrike, e cila mbetet e padukshme që nga zbulimi i saj dhe ndoshta për shkak të qëndrimit dhe sjelljes së konsumatorëve. Megjithatë, mundet të bëhet një çështje shumë e lehtë ***nëse konsumatori fiton njohuri bazë se çfarë është, si është energjia elektrike, si konsumohet dhe më e rëndësishmja se si harxhohet energjia.*** Kjo do t'i shtyjë konsumatorët të kenë më shumë vëmendje ndaj përdorimit të panevojshëm të energjisë elektrike dhe ka shumë të ngjarë të ndryshojë sjelljen e tyre të përditshme. Më tej zbatimi i stimujve, për të motivuar konsumatorët, në formën e një domosdoshmërie në lidhje me përfitimet sociale dhe ekonomike mund të ketë gjithashtu një efekt pozitiv. Ka patur prova se një kombinim i reagimeve me edukimin dhe interesin nxitës i motivon konsumatorët për të reduktuar përdorimin e energjisë elektrike.

Për një rezultat potencialisht të suksesshëm në kursimin e energjisë është i nevojshëm një vendim i vendosur për të ndërmarrë veprime për të filluar, e ndjekur me aplikimin dhe zbatimin e veprimeve specifike. Është e vërtetë që, ka shumë ide dhe mënyra se si të kursehet energjia, të cilat janë të disponueshme dhe lehtësisht të arritshme në ditët e sotme. Për shembull, ***përdorimi i teknologjisë më të mirë të disponueshme me sjelljen e praktikave më të mira ka qënë dhe vlerësohet si një mundësi që të reduktojë konsumin me 1300 kWh / vit për familje evropiane.*** Kjo megjithatë nuk e bën këtë përpjekje aq të lehtë sa duket nëse nuk plotësohen disa kërkesa. Përpara ***zbatimit të veprimeve të tilla duhet të ketë sukses në ngritjen e çështjes së ndërgjegjësimit për to si shumë thelbësore për t'u marrë parasysh.***

Kjo mund të arrihet përmes edukimit të duhur dhe njohurive bazë të veçorive të energjisë elektrike, të kombinuara me një kuptim të plotë të faktorëve të tjerë bindës të mëdhenj të rëndësishëm, veçanërisht qëndrimet dhe besimet mjedisore, si dhe konsideratat financiare. Për më tepër, domosdoshmëria për të qartësuar kuptimin e secilit term si dhe rëndësia dhe pesha e çdo faktori që ndikon tek sistemi në tërësi, mbetet ende i rëndësishëm.

Në mbarë botën në përgjithësi dhe në EU-27 në fushën specifike, ka një numër të konsiderueshëm studimesh shkencore të cilat lidhen me metodat dhe faktorët që janë domethënës në ruajtjen e energjisë. Studime të tilla janë kryer dhe po kryhen globalisht për të përcaktuar faktorët dhe metodat për rritjen e ndërgjegjësimit të konsumatorëve në vend.

Studime tipike të tilla mund të përmendim dy shembuj tipikë, të cilat janë dhënë më poshtë:

(i) Studimi për rritjen e ndërgjegjësimit të anëtarëve të familjes për përdorimin e tyre të energjisë, në planin afatgjatë, të ofrojnë një qëndrueshmëri të sjelljes së tyre me mjete efektive duke prekur zakonet e tyre.

(ii) Reagimet e informacioneve në kohë reale të ofruara nëpërmjet teknologjisë, duke raportuar se do të kemi 20% rënie të konsumit të energjisë nëpër banesa, duke u mbështetur tek një pajisje monitoruese e konsumit të regjistrimit të energjisë elektrike (*The Energy Detective, TED*) e cila u përdor si teknologji reagimi në lidhje me aplikacionin në internet të Google Power-Meter, duke e shfaqur grafikisht informacionin e konsumit në kohë reale.

Studimet e kryera, kanë treguar pa dyshim se ka një potencial të madh në kursimin e energjisë elektrike në familjet europiane dhe ndoshta, me investime minimale. Në përgjithësi, familjet konsumojnë shumë më shumë energji elektrike se sa ato kanë nevojë realisht, veçanërisht në rastet kur ato kanë punonjëse shtëpie apo dhe pishina.

Lidhur me perceptimin e duhur të pajisjeve që kërkojnë shumë energji, pavarësisht nga fakti se konsumi i saj ka një kuptim të gjerë i cili përbën një faktor kryesor, ku në mënyrë të pafavorshme ndikon në konsumin e energjisë, përdoruesit ende injorojnë kontributin negativ të pajisjeve të konsumeve të lehta (elektronike) të vazhdueshme dhe e përdorin atë në mënyrë të zgjatur. Për ngarkesat elektrike që konsumojnë më shumë energji, veçanërisht pishinat, ngrohja e ujit, tharësja e rrobave EAC, duhet të gjenden mënyrat e duhura për të inkurajuar konsumatorët që të përdorin të tilla ngarkesa në periudhat "jashtë pikut" të kërkesës për konsum të energjisë. Për më tepër, Autoritetet përkatëse duhet të gjejnë mënyra për të edukuar njerëzit mbi bazat e çështjeve të rëndësishme që po ndikojnë në konsumin e energjisë elektrike.

Çdo konsumator duhet të kuptojë se duke reduktuar konsumin e energjisë kontribuon në:

- a) **Ekonominë kombëtare,**
- b) **Reduktimin e ndikimit të ndotjes së mjedisit**
- c) **Shtimin e zgjatjes së stoqeve të lëndëve të para,**
- d) **Mbrojtjen e shëndetit e tij,**
- e) **Ofrimin e një të ardhmeje më shpresëdhënëse për brezat e rinj.**

Ekziston një kërkesë e domosdoshme për çdo vend që të gjejë mënyra për të bindur dhe inkurajuar konsumatorët që të kursejnë energjinë elektrike duke zbatuar politikat që mbështesin përpjekje të tilla qoftë financiarisht ose edhe ndryshe. Një monitorim i vazhdueshëm me sisteme në kohë reale, padyshim ndihmon në rritjen e ndërgjegjësimit të konsumatorëve duke ofruar edhe përfitime shtesë. Monitorimi mund të parandalojë edhe situata të padëshiruara edhe pse informacioni mund të jetë edhe asimetrik.

Për këtë janë përdorur metodat e inxhinierisë specifike, duke i bërë studiuesit të lidhin inxhinierinë me psikologjinë dhe artin mes tyre - për të ndihmuar në zgjidhjen e problemit specifik të ruajtjes së energjisë

Ajo që konstatohet nga studimi i psikologjisë njerëzore, tregon se ***sjellja njerëzore kontrollohet kryesisht nga tre (3) kategori kryesore të sjelljes.***

- *sjellja e ndërgjegjshme / vullnetare,*
